




| | | | |
|--------------------------------------|----------|---|--------------|
| REPUBLICA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA | | AGJENCIA KUNDER KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE ANTI-CORRUPTION AGENCY | |
| Dep. | 2-D /DPK | Nr. Prot. | 01-1380/2012 |
| Dep. | | Br.Prot. | |
| Nr. I faq. | | Prot No. | |
| Broj stranica | 02 | Data | |
| Nr. pages | | Datum | 17-04-2012 |
| | | Date | |
| PRISHTINE | | | |



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **27.03.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK – 03-4802/11, për z. HALIL KIKA – Anëtar i Bordit të Ndërrmarrjes Publike “Infrakos”, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti nr. AKK-03-4802/11 i hapur me Vendim të Drejtorit të datës 16.01.2012, nën dyshimin për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, për Zyrtarin e lartë, Halil Kika – Anëtar i Bordit të Ndërrmarrjes Publike “Infrakos” – Fushë Kosovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit, sipas të cilit zyrtari ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në ndërrmarrje private, që sipas Ligjit për Parandalimin e konfliktit të konfliktit të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese me datën 29.02.2012.

Pas kësaj shkrese njoftuese zyrtari i lartë, Halil Kika, është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë dhe në te ai është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyrën e shmangies së saj.

Pas këtij takimi zyrtari i lartë, z. Kika, ka sjell në Agjencinë kundër korrupsionit dokumentin zyrtar nga Agjensioni për regjistrimin e bizneseve, me numer protokoli DPK/DPKI, 03-1003/2012, në të cilin shihet se biznesi me emrin Agjensioni turistik “KIKA” është shuar në mënyrë vullnetare me datën 07.03.2012.

Në bazë të këtij dokumenti kemi konstatuar se është shmangur situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni /

